

BASHKIA TIRANË
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Operatori ekonomik “Inerti” shpk
Adresa: L. Sporti, Gramsh, Elbasan

Procedura e prokurimit: “Riparimi i mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa, në Njësinë Administrative Nr. 5, Njësinë Administrative Nr. 11, Njësinë Administrative Nr. 13 dhe Njësinë Administrative Nr.14”

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-89759-03-11-2021.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Tender i Kufizuar” me Marrëveshje Kuadër në kuadër të procesit të rindërtimit, e perzgjedhur në mbështetje të Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Udhëzimit Nr. 1, datë 13.02.2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik, pika 7.1; Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 35/1 si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu V, Neni 41.

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar: Sipas short-listing të pasqyruar në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

- 1) Operatori ekonomik “2T” shpk
- 2) Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Edonil” shpk & “Dearet Company” shpk
- 3) Operatori ekonomik “Inerti” shpk
- 4) Operatori ekonomik “Martin Konstruksion & Real estate” shpk
- 5) Operatori ekonomik “Shansi Invest” shpk

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazën tjetër të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “2T” shpk, NUIS K01731001M
Oferta ekonomike = 28,067,530 (njëzetë e tetë milion e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH.
2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Edonil” shpk & “Dearet Company” shpk, NUIS K11519006K & NUIS K01816001J
Oferta ekonomike = 28,154,060 (njëzetë e tetë milion e njëqind e pesëdhjetë e katër mijë e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.
3. Operatori ekonomik “Shansi Invest” shpk, NUIS 61924002T
Oferta ekonomike = 28,231,544 (njëzetë e tetë milion e dyqind e tridhjetë e një mijë e pesëqind e dyzetë e katër) lekë pa TVSH.
4. Operatori ekonomik “Martin Konstruksion & Real Estate” shpk, NUIS K81314023A
Oferta ekonomike = 28,291,153 (njëzetë e tetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e një mijë e njëqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.
5. Operatori ekonomik “Inerti” shpk, NUIS J66926804L
Oferta ekonomike = 28,000,716 (njëzetë e tetë milion e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë lekë pa TVSH.

Nuk ka operatore ekonomike të s’kualifikuara.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik “Inerti” shpk se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me 100 pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Autoritetit Përgjegjës, Bashkia Tiranë*, sigurimin e kontratës prej 15 % të vlerës së saj, siç parashikohet në Aktin Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Neni 43, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues vlerësuar me 99.8 pikë.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : 23 / 04 / 2021

Ankesa: Në fazën e parë të procedurës së prokurimit nuk ka pasur ankesa.